



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

SKENDER MERTURI, drejtor

10 Nr. 644-32637 / 19

Klinë, më 1.8.2019



KONKURS LETRAR

Për ÇMIMIN tradicional vjetor „ORA E TAHIR DESKUT” për veprën më të mirë letrare të botuar në mes dy manifestimeve letrare „ORA E TAHIR DESKUT”, i cili mbahet tradicionalisht më 7 shtator.

Kushtet për konkurrim:

Të drejtë pjesëmarrje kanë krijuesit letrar nga e gjithë hapësira shqiptare.

Konkurrimi fillon nga data e shpalljes në mjetet e informimit prej datë 1 gusht deri më 1 shtator 2019.

- Konkurrimi bëhet përmes nominimeve të institucioneve, shoqatave e asociacioneve letrare të regjistruara në Kosovë dhe individualisht.
- Preferohet që çdo vepër konkurruese të ketë disa nominime.
- Të ketë vlera të larta letrare dhe të jetë e përputhshme me Rregulloren e Manifestimit letrar.
- Çmimi letrar „TAHIR DESKU” ka vlerën në shumë prej 500 euro.
- Konkurruesit veprat duhet t’i sjellin në zyrat e DKRS-së nga tre (3) ekzemplarë për çdo libër.

Përveç çmimit tradicional, mbahet Ora letrare, ku ndahen çmimet për poezinë më të mirë: vendi i parë, i dytë, i tretë dhe çmimi stimulues për krijuesit e rinj.

Ftojme poetët që poezitë e tyre t’i dërgojnë në këtë email: alban.gashi@rks-gov.net

Poezitë që përzgjidhen për konkurrim do njoftohen përmes email-it.

Konkursi mbetet i hapur deri më 1 shtator, ndërsa juria shpall rezultatet më 7 shtator 2019, ditën e Manifestimit letrar „ORA E TAHIR DESKUT”.